

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E MARTË 1 NËNTOR 2022

E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Së pari, që në fillim më lejoni të theksoj se projektbuxheti i vitit 2023, duke përfshirë këtu edhe arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, energjinë, vjen në kontekstin e një situatë të vështirë, të shkaktuar nga lufta në Ukrainë, rreziku i inflacionit të luftës, kriza energjetike dhe të gjitha pasojat e këtij rreziku. Por, njësoj si në rastin e tërmetit dhe të pandemisë, edhe me këtë buxhet qeveria po tregon përgjegjshmëri dhe përkujdesje sociale, duke zgjedhur të mos e rritë çmimin e energjisë për familjarët dhe biznesin e vogël, si dhe duke u qëndruar pranë atyre që kanë më shumë nevojë, pensionistëve, familjeve me ndihmë ekonomike, nënave me shumë fëmijë dhe aftësisë së kufizuar. Gjithashtu dua të nënvizoj se buxheti i vitit 2023 në total, në raport me vitin 2013, është dyfishuar, tregues ky i progresit të Shqipërisë jo vetëm në ekonomi, por edhe në të gjitha fushat e tjera, përfshirë edhe arsimin.

Për sa i takon buxhetit të arsimit, nëse do t'i vendosnim një titull këtij buxheti, unë do të thosha që është buxheti i rritjes së pagave, i mbështetjes studentore, i rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Konkretisht buxheti për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ka reflektuar kërkesat kryesore për të realizuar objektivat dhe prioritetet, duke u shtuar tavaneve të miratuar në korrik të vitit 2022 edhe shumë prej 2 miliardë e 190 milionë lekësh ose 5% më shumë. Të gjithë zërat janë rritur, që nga shpenzimet e personelit, shpenzimet operative korrente, po ashtu edhe shpenzimet kapitale. Në total buxheti për Ministrinë e Arsimit, pra që administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, është 47 miliardë e 174 milionë lekë, i cili, krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2022, ka një rritje në vlerë nominale me 1 miliard e 715 milionë lekë ose 3,8%.

Por këtu dua të theksoj që, nëse këtij buxheti i shtohet edhe shtesa e pagave prej 6% për të gjithë punonjësit arsimorë, e cila do të fillojë zbatimin nga muaji korrik i vitit 2023, atëherë ky total do të arrijë në 48 miliardë e 674 milionë ose 3,2 miliardë më shumë se buxheti i miratuar i vitit 2022. Me këtë dua të them që ky fond parashikohet jashtë buxhetit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pra nuk evidentohet në tabelat tona, por është një rritje e parashikuar nga qeveria shqiptare, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe parashikon rritjen e të gjithë punonjësve mësimorë, duke filluar që nga

mësuesit, mësuesit ndihmës, punonjësit psiko-socialë, oficerët e sigurisë, dhe totali është 1 miliardë e 500 milionë lekë më shumë, që reflektohet në buxhet.

Nëse do të llogarisim të gjitha fondet e sektorit të arsimit, sepse këto që fola pak më parë janë fonde që administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, por ndërkohë sektori i arsimit përfshin edhe fonde që administrohen nga institucione të tjera, siç janë, për shembull, të ardhurat dytësore të institucioneve të arsimit të lartë, fondet që parashikon Ministria e Mbrojtjes për Akademinë e Forcave të Armatosura ose Ministria e Drejtësisë apo Ministria e Brendshme për Akademinë e Sigurisë apo Ministria e Financës dhe e Ekonomisë, fondet për arsimin profesional, fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore, që, gjithashtu, kanë zë të veçantë për arsimin, për infrastrukturën dhe për disa elemente të tjera. Nëse i llogarisim të gjithë këta zëra, që janë në projektbuxhetin e vitit 2023, të cilët nuk janë në Ministrinë e Arsimit, por në institucione të tjera, atëherë totali i sektorit të arsimit arrin vlerën e 68,6 miliardë lekëve, 3,2% e produktit të brendshëm bruto dhe rreth 10% e shpenzimeve publike.

Do të theksoja edhe diçka tjetër; përsëri këtu nuk i kemi dot të parashikuara dhe të llogaritura fondet për rindërtimin e shkollave të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit. Në total buxheti për rindërtimin, për vitin 2023, është në vlerën e 5 miliardë lekëve, natyrisht, këtu përfshihen shkollat, objektet e tjera arsimore, por edhe banesat. Në fillim të janarit ministria, që është përgjegjëse për administrimin e këtij fondi, në këtë rast është zëvendëskryeministrja dhe Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, do ta detajojë se sa nga ky buxhet parashikohet për arsimin. Kështu që në totalin e 68,6 miliardë lekëve, që ka sektori i arsimit, nuk është i përfshirë edhe ky zë, që do të thotë që, nëse në fillim të janarit kur ta kemi më të qartë sa do të jetë kjo shumë, kuptohet që nuk do të jetë më 3,2 përqindja ndaj produktit të brendshëm bruto, por do të jetë diku më e lartë, ndoshta, 3,5% apo edhe 4%, siç ka qenë edhe në vitet e shkuara.

Do të filloj me fondet për shpenzimet e personelit, sepse, natyrisht, ky është edhe zëri që ka ndjeshmërinë më të lartë për ju, por edhe për opinionin publik. Fondet për shpenzimet e personelit llogariten në vlerën e 30,3 miliardë lekëve për 31 mijë e 5 punonjës të sistemit arsimor, ku parashikohen, sigurisht, edhe shtesa e pagave me 6% për punonjësit arsimor, por edhe rritja me 7% e pagave të administratës së institucioneve arsimore, që nga ministria, zyrat arsimore, drejtoritë rajonale e kështu me radhë, që do të fillojnë zbatimin nga janari i vitit të ardhshëm. Këtë vit, siç e theksuam edhe në seancën dëgjimore “Për masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor”, kemi realizuar rritjen e numrit të punonjësve psikosocialë, të mësuesve ndihmës, të oficerëve të sigurisë. Të gjitha këto janë reflektuar në buxhetin e vitit 2023 me shuma konkrete. Për 1650 mësues ndihmës buxheti është

parashikuar në vlerën 1 miliardë e 584 milionë lekë, për 888 punonjës psikosocialë në shumën 721,8 milionë lekë, po kështu 220 oficerë sigurie kanë një buxhet prej 169,8 milionë lekësh.

Do të shtoja këtu shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të 2300 punonjësve mësimorë praktikantë. Këtë dua ta përsëris edhe një herë se këtë vit kemi marrë një vendim për ta shkurtuar kohën e praktikës mësimore, që bëjnë të diplomuarit për mësuesi përpara se të shkojnë në provimin e licencës, nga 1 vit e kemi bërë 3 muaj për ta përafuar me profesionet e tjera të rregulluara, por, mbi të gjitha, për të shkurtuar kohën që i duhet një studenti të ndjekë studimet, të diplomohet, të bëjë licencën, të aplikojë në portal dhe për t'u punësuar më pas. Për sa i takon arsimin parauniversitar, këtu, sigurisht, buxheti parashikon arsimin parashkollorë, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Buxheti për vitin 2023 për këtë zë arrin totalin e 51,4 miliardë lekë, ku orientohet kryesisht për shpenzimet e transportit, për 44 mijë e 300 nxënës, që kanë vendbanimin 2 kilometra larg nga shkolla dhe 12 mijë mësues që punojnë mbi 5 kilometra larg nga vendbanimi. Dua t'ju rikujtoj që vitin e kaluar, ne ndryshuam vendimin e Këshillit të Ministrave për ta rritur me 50% rimbursimin e biletës për nxënësit, në mënyrë që të mundësojmë realizimin e procedurave dhe rritjen e interesit të operatorëve që ofrojnë shërbimin e transportit për të shkuar në zona të largëta, në zona të vështira dhe buxheti i vitit 2023 e ka parashikuar edhe rritjen me 50% të rimbursimit të biletës. Kemi parashikuar, gjithashtu, blerjen e teksteve shkollore, që nga klasa e parë deri në klasën e nëntë për të gjithë.

Për shkollën e mesme kemi parashikuar 16 kategori, të cilat janë familjet në nevojë, nxënësit me aftësi ndryshe e kështu me radhë, por këtu do të theksoja që risia në këtë buxhet do të jetë që për klasat e para, të dyta dhe të treta, tekstet shkollore do të jenë njëpërdorimshme. Pra, nëse në klasat nga e katërta deri në të nëntën dhe kategoritë e gjimnazit kanë tekste në përdorim falas, sepse nxënësit, pasi mbaron viti shkollor, i dorëzojnë, pastaj i përdorin edhe dy breza të tjerë, në total përdoren prej tri brezash nxënësish. Për klasën e parë, të dytë dhe të tretë kemi gjykuar se është e vështirë, jofunksionale, joeficiente që librat të përdoren përsëri, sepse nxënësit janë më të vegjël dhe nuk arrijnë dot t'i mirëmbajnë, por edhe tekstet janë të tilla që kanë shënime dhe është e vështirë të fshihen dhe të jenë të përdorshme, sikurse ishin të rinj.

Në buxhet kemi parashikuar që tekstet për klasat e para deri në të tretën do t'i kenë totalisht falas dhe do të përdoren vetëm prej tyre. Buxheti për arsimin parauniversitar, natyrisht, mbulon edhe bursat apo kuotat ushqimore për nxënësit me nevoja të veçanta, por edhe për nxënësit që kanë rrezik të lartë braktisjen shkollore. Janë rreth 1200 deri në 1500 nxënës të arimit parauniversitar, që do të përfitojnë

nga këto bursa apo kuota ushqimore me një buxhet në total në vlerën prej 170 milionë lekësh. Ndërkohë, kemi parashikuar edhe buxhetin për maturën shtetërore në vlerën 25 deri në 30 milionë lekë. Dua të theksoj faktin se këtë vit kemi vendosur që për provimet e maturës në programin “Mjekësi e përgjithshme” maturantët, përveç formulës dhe provimeve, që janë aktualisht sipas legjislacionit në fuqi, të kenë edhe një provim të automatizuar shtesë, i cili rrit edhe më shumë meritokracinë dhe transparencën. Do të jetë një provim, i cili do të zhvillohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore në formatin e sotëm të provimeve të licencave apo të portalit, krejtësisht i automatizuar, në një kohë kur testi gjenerohet në moment dhe korrigohet menjëherë, ku edhe rreziku i gabimit, koha, shpenzimet e administrimit, sigurisht, do të jenë shumë më të ulëta.

Kjo do të pilotohet me programin “Mjekësi e Përgjithshme”, meqenëse është programi më i kërkuar dhe aty shkojnë maturantët më të shkëlqyer, ndërkohë kemi qëllimin që ta shtrijmë edhe për provimet e tjera të maturës. Kemi parashikuar për programin e ri “Arti dhe zejet”, i cili do të fillojë nga janari i vitit të ardhshëm, një fond prej 100 milionë lekësh. Dua ta specifikoj se çfarë nënkupton ky fond. Ne gjatë gjithë këtij viti kemi punuar për hartimin e kurrikulës, pra për hartimin e programit, për përgatitjen e mësuesve, për identifikimin e shkollave dhe, së fundmi, për blerjen e materialeve, bazës didaktike, që do të ndihmojnë për realizimin e këtij programi. Nga janari fillon zbatimi i programit dhe 100-milionëshi do të jetë i dedikuar vetëm për mësuesit, që do të angazhohen në këtë program, sepse të gjithë mësuesit që do të angazhohen do të kenë pagesë ekstra, përtej pagës që marrin për orarin e tyre zyrtar.

Ky do të jetë një program që do të zhvillohet përtej orarit mësimor, ndaj është quajtur programi jashtë orarit mësimor. Kemi parashikuar në buxhet, gjithashtu, investimet në infrastrukturë, të cilat për vitin 2023, janë në vlerën 1,7 miliardë lekë. Përparësi do të kenë investimet që kanë filluar, 25 objekte për të cilat financimi është parashikuar në dy vjet, ndërkohë që ky do të jetë një investim i qëndrueshëm. Në projektbuxhet është parashikuar për vitin 2024, por edhe për vitin 2025 një total në shumën 5,2 miliardë lekë, ku parashikohen 120 deri në 150 objekte arsimore të reja apo të rikonstruara, ku përfitojnë 25 deri në 30 mijë nxënës, 2500 deri në 3000 mësues apo edukatorë e kështu me radhë. Këtu kemi parashikuar edhe 450 milionë lekë, që është pjesa e bashkëfinancimit me organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, sepse çdo financim që bën Ministria e Arsimit dhe e Sporteve ka kushtin që edhe vetë bashkitë të kontribuojnë; natyrisht në varësi të përmasave të tyre, kontributi mund të jetë 10%, 15% apo 20%.

Kuptohet që në bashkitë më të mëdha, që kanë edhe më shumë të ardhura, bashkëfinancimi është në një nivel më të lartë. Kemi parashikuar edhe pajisje shkollore, mobilie, tavolina siç llogariten çdo vit. Nuk

po ndalem në këto detaje. Kemi parashikuar pajisje elektronike për kompjuterë apo laptop, dhe këtu do të ndalem pak më gjatë, sepse përfshirja në kurrikul e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është reflektuar me investime në infrastrukturë, me ato SmartLabs, që deri më sot i kemi vetëm në 100 shkolla, si projekt pilot, por me buxhetin e vitit 2023 dhe buxhetet e viteve në vazhdim 2024, 2025 kemi parashikuar që ky projekt të shtrihet edhe në shkolla të tjera. Ndërkohë, dua të theksoj që me partnerët tanë zhvillimorë, me donatorë të ndryshëm, po punojmë që edhe ata të japin kontributin e tyre për rritjen e numrit të shkollave që përfshihen në këtë projekt. Fondi i bibliotekave shkollore këtë vit ka një rritje të lehtë prej 25 milionë lekësh. Ndërkohë, kemi pajisje didaktike-mësimore për lëndët fizikë, kimi, biologji.

Këtë vit ne patëm një buxhet të konsiderueshëm me laboratorë, që tashmë nuk janë të standardeve të mëparshme, por janë laboratorë të rinj, me standarde më të larta. Investimi dhe politika jonë është e qëndrueshme, siç investuam këtë vit, do të vijojmë edhe në vitet pasardhëse deri në vitin 2025, që janë të parashikuara në projektbuxhet. Për ta mbyllur me arsimin parauniversitar, dua të theksoj dhe njëherë këtu në pasqyrat, në tabelat tona nuk janë përfshirë fondet për shkollat e rindërtuara nga tërmeti. Janë 185 objekte arsimore që janë përfshirë në këtë program dhe ne i kemi të detajuara sa janë nga buxheti i shtetit, sa janë nga donatorët, siç është "EU4Schools", UNDP dhe kështu me radhë. Ndërkohë, për sa u takon arsimin të lartë dhe kërkimit shkencor për vitin 2023, ky financim arrin shumën totale të 12,6 miliardë lekësh, me një rritje totale prej 9,2% ose 1,1 miliardë e 58 milionë krahasuar me buxhetin e vitin 2022.

Këtu nuk kemi përfshirë të ardhurat e vetë institucioneve të arsimin të lartë, të cilat përlllogaritet 3,1 miliardë lekë. Pra, në total buxheti i arsimin të lartë dhe i kërkimit shkencor shkon 15,7 miliardë lekë ose 0,6% e produktit të brendshëm bruto. Nëse programin e arsimin të lartë dhe atë të kërkimit shkencor i ndajmë, rritja në arsimin e lartë është me 774 milionë lekë, pra 7,2% krahasuar me vitin 2022, ndërsa për kërkimin shkencor kjo rritje është shumë më e ndjeshme dhe shkon në 38,2% më shumë krahasuar me vitin 2022. Dua të theksoj se këtu përfshihet edhe financimi i huaj në kuadër të programeve të Bashkimit Europian, nisur nga performanca e universiteteve tona që, kryesisht, vitin e fundit është rritur jo vetëm në numër aplikimesh, por edhe në nivel suksesi. Ku do të orientohet e gjithë kjo rritje e buxhetit për arsimin e lartë dhe për kërkimin shkencor, për sa u takon zërave të veçantë? Dua ta nis me shtesën e pagave të pedagogëve.

Në muajin shtator qeveria mori vendimin të rrisë deri në 15% pagat e pedagogëve, ku 7% do të mbulohet direkt nga buxheti i shtetit, gjë që ka filluar prej datës 1 tetor, dhe pjesa tjetër, deri në 15%, do

të mbulohet nga vetë institucionet e arsimit të lartë, në varësi të të ardhurave të tyre. Vlera e rritjes në buxhet, për të parashikuar rritjen me 7%, është 400 milionë lekë, ndërkohë që lajmi i mirë është se 3 universitete publike tashmë kanë miratuar në senatet e tyre akademike, por edhe në bordet e administrimit, pjesën tjetër të rritjes prej 8%. Pra, në këtë moment në Universitetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin e Sporteve të Tiranës pagat e pedagogëve janë rritur me 15%. Një tjetër prioritet yni për arsimin e lartë është ndërkombëtarizimi i universiteteve për programe studimi të përbashkëta apo të dyfishta, për mbështetjen e programeve të reja në gjuhën angleze dhe totali i shumës së parave për ndërkombëtarizimin e universiteteve është 616 milionë lekë.

Kjo shumë është e ndarë në 2 drejtime, sepse 400 milionë janë shpenzime korente për të përballuar hapjen e programeve, pagesat e pedagogëve, shkëmbimet e pedagogëve, literaturën, bursat për studentët në programe të caktuara dhe 216 milionë lekë janë investime në infrastrukturën që do të mbështesë hapjen e këtyre programeve, si laboratorë apo pajisje kërkimore shkencore. Dua t'ju kujtoj që në vitin 2022, pra këtë vit, kemi financuar 24 projekte nga universitetet, pikërisht në kuadër të ndërkombëtarizimit të tyre. Pra, buxheti prej 369 milionë lekësh është shpërndarë në të gjitha universitetet publike shqiptare, nëpërmjet një thirrjeje të hapur, ku ato kanë aplikuar, bazuar në programet e përbashkëta apo të dyfishta që tashmë janë realizuar dhe janë funksionale.

Me të njëjtën mënyrë do të vijojmë edhe vitin e ardhshëm për të mbështetur edhe hapjen e programeve, por, sidomos për infrastrukturën, e cila bën të mundur jo vetëm funksionimin e këtyre programeve, por edhe suksesin e tyre. Ndërkohë, për mbështetjen studentore, një zë ky shumë i rëndësishëm në këtë buxhet, kemi 4 politika të ndryshme. Së pari, vijojmë me "Paktin për universitetin" për të mbështetur rreth 12 mijë studentë që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë apo të ciklit të dytë. Sigurisht, këtu janë përfshirë studentët që e kanë mesataren mbi 9, por edhe ata që vijnë nga kategori të caktuara në nevojë. Ndërkohë, risia e këtij viti, përtej "Paktit për universitetin", është mbështetja studentore për ekselentët dhe për ata studentë që ndjekin programe që janë prioritet në zhvillimin e vendit.

Përpara disa muajsh ne kemi miratuar një vendim në Këshillin e Ministrave, ku kemi renditur të gjitha programet që janë prioritet për zhvillimin e vendit, duke përfshirë mësuesinë, programe në fushën e bujqësisë, të turizmit dhe në disa fusha të tjera. Janë 3 kategori studentësh që do të përfitojnë përjashtim nga tarifat dhe bursa të barasvlershme me pagën minimale, pra 340 mijë lekë të vjetër në muaj. Në kategorinë e parë përfshihen maturantët ekselentë, pra ata që në 3 vjetët e gjimnazit i kanë të gjitha rezultatet 10 dhe që në provimet e maturës kanë një mesatare mbi 9,8. Në kategorinë tjetër janë

të gjithë ata maturantë që do të përfundojnë gjimnazin me mesatare mbi 8,5, por do të zgjedhin një nga programet prioritare. Kjo do të bëhet për t'i nxitur këto programe, të cilat ne i kemi shpallur programe prioritare.

Në kategorinë e tretë do të përfshihen të gjithë ata maturantë që do të kenë fituar një olimpiadë ndërkombëtare dhe që do të zgjedhin një program, i cili lidhet me fushën ku kanë fituar çmimin në 1 nga 3 vendet e para të kësaj olimpiade qoftë ballkanike, europiane apo botërore. Buxheti që kemi parashikuar për vitin 2023 vetëm për këtë kategori është 150 milionë lekë. Një tjetër kategori për mbështetjen studentore përfshin studentët që tashmë kanë përfituar nga fondi i ekselencës dhe do të studiojnë në një nga 15 universitetet më të mira, sipas renditjes së Times Higher Education. Ne e kemi ndryshuar politikën për këtë fond, por të gjithë ata që tashmë i kanë filluar studimet, natyrisht, ne do t'i mbështesim deri në finalizimin e këtyre studimeve dhe diplomimin e tyre.

Pra, kemi shtuar në buxhet edhe një fond për ata që i kanë filluar studimet vitin e kaluar dhe, bazuar në marrëveshjen që kanë me Ministrinë e Arsimit, do ta mbyllin të gjithë ciklin e studimeve, duke shpresuar që më pas të kthehen dhe të japin kontribut për vendin e tyre. Kategoria tjetër përfshin studentët fulbright, nisur nga marrëveshja e qeverisë shqiptare me qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Buxheti këtu shkon rreth 20 milionë lekë në vit, për studentët që fitojnë të drejtën të jenë pjesë e këtij programi të shkëmbimit akademik mes 2 vendeve tona. Për sa i takon akomodimit të studentëve në shoqëritë e trajtimit të tyre në Tiranë, por edhe në qytete të tjera, kemi parashikuar një fond prej 250 milionë lekësh, përfitues të të cilit janë rreth 600 mijë studentë.

Natyrisht, janë shoqëritë në varësi të njërive të vetëqeverisjes vendore që i administrojnë këto fonde, të cilat edhe shtojnë nga të ardhurat e tyre, për t'i plotësuar më mirë nevojat e studentëve gjatë akomodimit të tyre në konvikte apo në rezidenca universitare. Investimet kapitale në infrastrukturën e arsimit të lartë, pra investimet në godinat universitare, janë 880 milionë lekë nga buxheti i shtetit për vitin 2023, ku përfshihen projekte të reja, por edhe projektet që janë në vijimësi të parashikuara me financim 2 apo 3-vjeçar. Edhe këtu politika jonë është e qëndrueshme, sepse për vitet 2023-2025 në PBA kemi parashikuar 2,5 miliardë lekë për financimin e projekteve të infrastrukturës së institucioneve publike të arsimit të lartë.

Ndërkohë, lidhur me kërkimin shkencor kemi Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe të Inovacionit, e cila administron një buxhet të konsiderueshëm në mbështetje të universiteteve dhe të qendrave kërkimore shkencore. Gjithashtu, kemi investime në laboratorët kërkimorë shkencorë, për të

cilët është një buxhet i veçantë. Bazuar në një thirrje, ku të gjitha universitetet aplikojnë me projektet e tyre, bordi i administrimit të kësaj Agjencie, në bazë të pikëzimit, të renditjes dhe të prioriteteve të vendosura, bën më pas edhe shpërndarjen e fondit. Për vitin 2023 janë parashikuar 250 milionë lekë për rreth 20 apo më shumë projekte, pasi ne mund të parashikojmë sasinë e fondit, por jo numrin e projekteve apo të universiteteve që do të aplikojnë, sepse kjo varet nga vlera e projekteve, nga angazhimi i universiteteve e të tjera. Lidhur me grantin e punës kërkimore shkencore dhe veprimtaritë krijuese, për vitin 2023 kemi parashikuar 1 miliardë e 31 milionë lekë, një rritje prej 38,2% dhe këtu dua ta specifikoj arsyen e kësaj rritjeje të konsiderueshme.

Në radhë të parë është financimi i programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik, financim prej 70 milionë lekësh, dhe këtu janë vetë IALTë që aplikojnë me projekte. Janë rreth 3500 kërkues të përfshirë në këto aplikime. Ndërkohë janë projektet e bashkëpunimit të universiteteve me biznesin privat në programet kombëtare të zhvillimit, financim që shkon në rreth 60 milionë lekë. Gjithashtu, është pjesëmarrja në programin “Horizon Europe”, për të cilin është bërë një rritje e konsiderueshme. Dua të theksoj se nga programi “Horizon 2020” në programin “Horizon Europe” suksesi i universiteteve është rritur, nga 8% në 38%. Tashmë universitetet tona kanë rritur kapacitetet edhe për mënyrën se si hartohet një projekt.

Bashkëpunimi dhe përfshirja e tyre në rrjetet e universiteteve më të zhvilluara dhe më prestigjioze në Europë ka bërë që tashmë universitetet tona të kenë fituar 2,1 milionë euro vetëm në vitin e parë. Siç e dini, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka lidhur marrëveshje me Komisionin European, për të paguar çdo vit një tarifë vjetore prej 160 milionë lekësh, që t’u japë mundësi universiteteve tona të aplikojnë dhe të përfitojnë sa më shumë. Premisat janë shumë të mira dhe jemi shumë optimistë, sepse krahasuar me programin e mëparshëm suksesi i universiteteve tona është rritur, aq sa tashmë kemi edhe universitete që janë lidere në projekte, siç e thashë. Nëse deri dje universitetet përfitonin kur i bashkëngjiteshin një grupi tjetër universitetesh dhe ishin pjesë e partneritetit, sot kemi universitete lidere, përkundrejt universiteteve që mund të jenë shumë herë më të fuqishme dhe shumë më tepër prestigjioze. Kjo tregon që kapacitetet janë rritur dhe tashmë ne duhet ta shfrytëzojmë këtë.

Këtë marrëveshje që ka lidhur Ministria e Arsimit, qeveria shqiptare, me Bashkimin European duhet ta shfrytëzojmë maksimalisht, në mënyrë që thithja e fondeve të mos jetë si në programin e mëparshëm, kur nuk arrinim të merrnim mbrapsht as shumat që paguanim. Në kuadër të Bashkimit European kemi edhe programe të tjera për kërkim dhe inovacion, si programet “Interreg”, “Eureca” dhe shumë projekte të tjera, në të cilat edhe universitetet tona e kanë rritur nivelin e suksesit dhe përfitojnë prej tyre.



Ndërkohë, ne kemi përfshirë në buxhet rreth 25 milionë lekë në vit, pjesë që i takon Ministrisë së Arsimit për bashkëfinancim të universiteteve, në rastin kur ato janë të suksesshme dhe përfitojnë fonde. Së fundmi, për sa i takon programit të sportit, sepse Ministria ka si prioritet edhe sportin, duke qenë Ministri e Arsimit dhe Sportit, në raport me vitin e kaluar buxheti është rritur me 7,8%, në total janë 446 milionë lekë, që do të thotë se është një shtesë prej 33 milionë lekësh më shumë se viti 2022.

Ky fond garanton mbështetje për federatat sportive olimpike dhe joolimpike, për të marrë pjesë në aktivitete ballkanike, europiane dhe botërore, në lojërat olimpike, gjithashtu, për të realizuar analizat antidoping për sportistët elitarë dhe për mbështetjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, me rreth 160 milionë lekë në total, për mbështetjen e të gjitha këtyre federatave. Ndërkohë kemi rritur buxhetin për shpërblimet e sportistëve elitarë dhe këtu dua të theksoj se gjatë këtij viti kemi pasur rezultate shumë të mira nga sportistët tanë në gara dhe në olimpiada ndërkombëtare. Ata kanë marrë medalje më shumë se çdo vit tjetër dhe, detyrimisht, kemi rritur buxhetin, sepse, sipas legjislacionit të ri, shpërblimet parashikohen për sportistët fitues të këtyre medaljeve, por edhe për trajnerët e tyre, sikurse edhe për kategorinë e të rinjve fitues në këto olimpiada.

Nga njëra anë, është ndryshimi i ligjit “Për sportin” i vitit 2019 dhe, nga ana tjetër, është vendimi i fundit i Këshillit të Ministrave në vitin 2021, në të cilin u përafrua mënyra e shpërblimit të sportistëve elitarë shqiptarë me mënyrën e shpërblimit të sportistëve elitarë sipas legjislacionit të vendeve europiane, çka ka nxitur dhe motivuar më shumë sportistët tanë. Natyrisht, ky përmirësim i rezultateve dhe rritja e numrit të medaljeve, në radhë të parë është falë meritës, punës, përkushtimit dhe talentit të tyre, por jam e bindur se është edhe falë stimujve që tashmë kemi vendosur me legjislacionin e ri, ku çdo sportist në momentin e parë që merr medaljen, merr edhe shpërblimin përkatës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe sipas parashikimeve.

Kemi parashikuar edhe 150 milionë lekë për investime në infrastrukturën sportive. Po kështu, kemi projektin “Ekipet sportive 2022”, që e nisëm këtë vit dhe do të çelet në muajin nëntor. Qeveria shqiptare financon 500 milionë lekë për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, që zbaton projektin “Ekipet sportive 2022” për volejboll dhe basketboll në të gjitha shkollat dhe në të gjitha universitetet e vendit, për të krijuar ekipet dhe më pas për zhvillimin e kampionateve në nivel bashkie, në nivel qarku dhe në nivel kombëtar. Këtu do të identifikohen edhe talentet që do të mbështeten dhe do të zhvillohen drejt sportistëve elitarë. Gjithashtu, kemi edhe projektin “Be active”, në bashkëpunim me Bashkimin Europian dhe këtu kemi parashikuar 20 milionë lekë për mbështetjen financiare të aktiviteteve sportive në shkollat e arsimit parauniversitar.

Unë këtu do të ndalem, duke ju kërkuar ndjesë, sepse ndoshta u zgjata, por dua ta mbyll fjalën time me theksin që i vura projektbuxhetit në fillim, lidhur me drejtimet kryesore të tij, që janë, pikërisht, rritja e pagave; rritja e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe në arsimin e lartë; mbështetja studentore dhe ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë. Ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen!